

D E K R E T
Nr.1631, datë 1.11.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7926, DATË 20.4.1995 “PËR TRANSFORMIMIN E
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRL TREGTARE”, NDRYSHUAR ME
DEKRETIN NR.1195, DATE 14.8.1995 DHE LIGJIN NR. 8099, DATE 28.3.1996**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Neni 4 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshohen si më poshtë:

Shteti, si pronar i vetëm i pronës shtetërore përfaqësohet nga Ministria e Privatizimeve.

Ministria e Privatizimeve kryen transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare dhe privatizimin e tyre. Ajo nënshkruan kapitalin themeltar të këtyre shoqërive.

Ministritë e tjera dhe Departamenti Shtetëror i Postave përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore që kanë në varësi.

Prona shtetërore në shoqëritë me kapital të përbashkët vendas dhe të huaj administrohet nga organi që ka bërë derdhjen e kapitalit. Transferimi i kapitalit të pjesës shtetërore në këto shoqëri bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 2

Neni 5 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, shfuqizohet.

Neni 3

Neni 6 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshohet si më poshtë :

Ministria e Privatizimeve drejton punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve dhe autorizon regjistrimin e tyre.

Neni 4

Neni 7 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshohet si vijon:

Ministri i Privatizimeve ka të drejtë të marrë masa disiplinore deri në largimin nga detyra për çdo drejtues të ndërmarrjes shtetërore, i cili ka penguar transformimin dhe regjistrimin e ndërmarrjes shtetërore në shoqëri tregtare.

Neni 5

Neni 8 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshohet si më poshtë:

Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3 deri në 9 anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri. Një e treta e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrëse emërohen nga Ministria e Privatizimeve dhe dy të tretat nga ministritë e tjera dhe Departamenti Shtetëror i Postave dhe Telekomunikacionit.

Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës kur për të bien dakord jo më pak se tre të katërtat e Këshillit Mbikëqyrës.

Shpërblimi i veçantë për pjesëmarrje në Këshillin Mbikëqyrës dhe shpërblimet e

jashtëzakonshme për shërbimet a detyrat që u besohen anëtarëve të Këshillit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 109 i ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, nuk zbatohet për aq kohë sa shteti do të jetë aksioner i vetëm.

Neni 6

Në ligjin nr. 7996, datë 20.9.1995 “Për miratimin e dekretit nr. 1195, datë 14.8.1995 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, dhe në ligjin nr. 8099, datë 28.3.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, fjala “Ministria e Financave” zëvendësohet me fjalën “Ministria e Privatizimeve”.

Neni 7

Ligji nr. 8067, datë 15.2.1996, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë dekret, shfuqizohet.

Neni 8

Dekreti nr. 1615, datë 20.9.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, shfuqizohet.

Neni 9

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha